



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË DOKUMENTACIONIT TË KANDIDATIT PËR KRYETAR
BASHKIE DURRËS TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "KOMBËTARE KONSERVATORE
ALBANIA" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30
QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthimin për plotësim të dokumentacionit të kandidatit për Kryetar Bashkie Durrës të depozituara nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N:

Partia "Kombëtare Konservatore Albania", me vendimin nr. 40 datë 13.03.2019 "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor Partia Kombëtare Konservatore Albania, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019" është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".



Nr. 536 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatit për Kryetar Bashkie Durrës të depozituara nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Kombëtare Konservatore Albania, ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për regjistrimin si kandidat për kryetar bashkie z. Tomor Qama.

Në mbledhjen e datës 18.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi dokumentacionin e kandidatit për Kryetar Bashkie Durrës, z. Tomor Qama dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Deklarata e kandidatit i cili deklaroi se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Durrës, të propozuar nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
2. Kopje e letërnjoftimit të z. Tomor Qama sipas së cilës rezultoi se z. Tomor Qama është me vendbanim në Bashkinë Durrës;
3. Jetëshkrimin e z. Tomor Qama si kandidat për kryetar të bashkisë Durrës;
4. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga kandidati për kryetar bashkie.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Tomor Qama, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 536 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 12:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatit për Kryetar Bashkie Durrës të depozituar nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019